

STATUT
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“LA BLESS VENIRE”

(Hartuar ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar).

Shoqeria “**La Bless Venire**” shpk, eshte krijuar mbi bazen e Akt - Themelimit te Ortakut te Vetem : **Natasya Wahyu Prativi**, e datelindjes 17.02.1999, ne adresen: Rr “Komuna e Parisit” ZK 8260, NP 6/366+1-56, Njesia Bashkiake Nr 5, Tirane, qytetare Indoneziane, e identifikuar me pasaporten nr. X2046962, madhore e me zotesi te plote per te vepruar, per te zhvilluar aktivitetin tregtar, i cili kane vendosur te perpiroje kete Statut si me poshte:

Neni 1

Emertimi

Shoqeria eshte quajtur “**La Bless Venire**” shpk.

Ajo eshte subjekt juridik shqiptar dhe ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit te saj. (Akt –Themelimi dhe Statuti).


Asambleja e Ortakeve themelues ne kete siper marrje ka derdhur kapitalin me qellim qe te perfitoje te ardhura, qe mund te vijne nga ushtrimi i veprimtarise private. Ajo perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se derdhur ne kapitalin themelor.

Neni 2

Objekti

Objekti i aktiviteti ekonomik te shoqerise eshte:

- Sherbimi e ndermjetesimi ne punesim, informim per vende te lira te punes, keshillim dhe orientim per pune dhe profesion, informacion dhe udhezime per punesim, vleresim te nevojave, zhvillim te karrieres apo te profesionit, metodika per punesim. Sherbime ndermjetesimi ne te dy kahet per punedhenesin por edhe per punemarresin, apo sherbime ndermjetesimi te pa lidhura ngushtesisht me çeshtjet e vetem punesimit etj. Sherbime per punedhenesin, kryesisht informacion per tregun e punes, sherbime te ofrimit te kandidateve te mundshem per rekrutim ne pune, informacion per programet e ndryshme te tregut te punes etj.
- Veprimtari ne fushen e punesimit ne Republiken e Shqiperise dhe vende te tjera, rekrutimin e punetoreve te huaj nga vende te tjera, vende te ndryshme te botes, per profesione te ndryshme, si ne industrine e hotelerise turizem, bar restorant, ndertim, sherbime te ndryshme familjare, komplekse sportive dhe palester, rrobaqepesi, etj pa u kufizuar vetem ne to, si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme qe nuk bie ndesh me legjislacionin ne fuqi, si dhe punesimi i shtetasve shqiptare ne vende te ndryshme sipas aftesive dhe cilesive te tyre profesionale.



Konsulence dhe asistence e specializuar ne fushat e sipercituara per problemet e punesimit.

- Sherbimet ne fushen e emigracionit. Nen kete percaktim ofrojme keshillim dhe ndermjetesim ne punesim ne kuader te percaktimeve te legjislacionit per te huajt, i cili rregullon regjimin e hyrjes, te qendrimit, punesimit, trajtimit dhe te daljes se te huajve nga Republika e Shqiperise.
- Hapja e qendrave te rekreacionit, te estetikes, trajtimit te lekures dhe trupit, per masazhe, spa, mirembajtje trupore, fitness, e te tjera te kesaj natyre.
- Import-Eksport, tregtim te mallrave, qe kane te bejne me aktivitetin e mesiperm.

Per ushtimin e veprimtarise se saj, shoqeria mund te hape njesi sherbimi brenda dhe jashte vendit duke bashkepunuar me persona fizike dhe juridike vendas dhe te huaj.

Duhet te konsiderohet e perfshire ne objektin e shoqerise, kryerja e çdo veprimtarie tjeter te ngjashme, te lidhur, te nevojshme ose te dobishme per zhvillimin e veprimtarise se mesiperme, si per vete, ashtu dhe per llogari te te treteve.

Neni 3

Selia

Shoqeria “**La Bless Venire**” shpk e ka seline e saj tek: **Rr “Komuna e Parisit” ZK 8260, NP 6/366+1-56, Njesia Bashkiake Nr 5, Tirane.**

Ajo ka te drejte te krijojte brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise filiale, agjensi, perfaqesi, seli sekondare dhe ti suprimoje ato.

Neni 4

Kohezgjatja e Shoqerise

Shoqeria tregtare “**La Bless Venire**” do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike me nje afat te pacaktuar.

Neni 5

Kapitali I Shoqerise

Kapitali i shoqerise eshte 500,000 (peseqindmije) leke, i perbere nga 1 kuote me vlere nominale 500,000 leke e cila zoterohet 100% nga ortaku i vetem i shoqerise **Znj. Natasya Wahyu Prativi.**

Kapitali i shoqerise mund te ndryshoje sipas vendimit qe do te marre Asambleja e Ortakeve, ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar.

Neni 6

Pjeset e kapitalit themelor jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie, ne rast ndarje pasurore ndermjet bashkeshorteve, paraardhesve e pasardhesve. Ne rast vdekjeje te ndonjerit prej ortakeve pjesa e kapitalit qe ai disponon i kalon te trashegimtaret e tij dhe kur asnjeri nga pjestaret e familjes nuk pranon te punoje ne ortakeri, atehere u jepen te gjitha fitimet qe ju

takojne sipas kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar. Te gjitha pjeset e kapitalit te shoqerise mund t'u kalojne, t'u transferohen personave te trete, qe nuk bejne pjese ne ortakeri sipas menyrave te percaktuar ne ligj. Ne rastin e kalimit te kutova me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim. Trashegimtari hyn ne shoqeri me te gjitha te drejtat e ortakut dhe me te gjitha efektet.

Neni 7

Kapitali i Shoqerise perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe te tjera te nevojshme per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Neni 8

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarise ekonomike i Shoqerise do te administrohet nga Asambleja e Ortakeve. Nje pjese te ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqeria eshte e detyruar te shlyeje te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve.

Neni 9

Shoqeria eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje te drejta te tjera materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se saj tek te tjeret, te tretet. Ne Republiken e Shqiperise Shoqeria Tregtare "**La Bless Venire**" shpk gezon te drejta sikunder cdo person tjeter juridik dhe fizik shqiptar ose i huaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 10

Organizimi Dhe Administrimi Ne Shoqeri

Organi vendimarrës i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

Asambleja e Ortakeve ka te drejte per te vendosur per ceshtje te tilla si: percaktimi i politikave tregtare te shoqerise, emerimi ose shkarkimi i administratoreve, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive, ndarja e fitimit, zvogelimi i kapitalit themelor ose zmadhimi i tij, transferimi i pjeseve te kapitalit themelor te te tretet, zgjatja e afatit te veprimtarise se shoqerise apo likuidimi i saj, shnderrimi i shoqerise ne nje forme tjeter, ne nje nga format e parashikuara nga ligji, ndryshimi i statutit e te tjera ceshtje te parashikuara nga ligji.


Neni 11

Asambleja e Ortakeve mbledhjet e zakonshme i ben cdo vit brenda 6 muajve nga mbyllja e veprimtarise ekonomike te shoqerise.

Neni 12

Administratori

Shoqeria administrohet nga **Natasya Wahyu Prativi**, e datelindjes 17.02.1999, banuese ne adresen: Rr "Komuna e Parisit" ZK 8260, NP 6/366+1-56, Njesia Bashkiake Nr 5, Tirane,



qytetare Indoneziane, e identifikuar me pasaporten nr. X2046962, madhore e me zotesi te plote per te vepruar.

Administratori qendron per nje periudhe 5 vjecare ne detyre, me te drejte rizgjedhjeje. Asambleja e Ortakeve gezon te drejten ne cdo kohe te shkarkoje nga detyra administratorin dhe te emeroje nje tjeter ne vend te tij.

Administratori ka keto kompetenca:

- Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimatrise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga ortaku.
- Perfaqeson shoqerine tregtare.
- Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te librave kontabel te shoqerise.
- Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor te shoqerise brenda dates 31 mars, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimit te cilat i paraqiten ortakut per miratim.
- Kryen detyra te tjera te percaktuar ne ligj.

Neni 13

Viti Financiar, Llogarite Vjetore

Administratori parashikon brenda 31 marsit perfundimin e pasqyrave financiare duke ia paraqitur Asamblese se Ortakeve per miratim.

Neni 14

Cdo vit financiar fillon me 1 janar te cdo viti dhe perfundon me 31 dhjetor, me perjashtim te vitit te pare ku si fillim eshte data e regjistrimit te shoqerise.

Neni 15

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret, apo nga ekspertet kontabel, miratohen nga Asambleja e Ortakeve. Miratimi i dokumentave financiare vjetore behet brenda nje afati 3-mujor, mbas dates se mbylljes se vitit financiar.

Neni 16

Mbas miratimit te llogarive vjetore Asambleja e Ortakeve mund te vendose shperndarjen e fitimit ne forme dividenti ne perputhje me nenin 77 te ligjit Nr 9901.

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se sigurimeve shoqerore, dhe detyrimeve te tjera. Ajo ka te drejte te cele llogari likuiduese prane bankave te vendit dhe te kryeje veprime likuidimi me to.

Neni 17

Marredheniet E Punesimit

Marredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen nepermjet Kontrates se Punesimit, qe lidhet midis paleve ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, i cili ben fjale per punesimin.



Neni 18

Largimi nga puna behet me mbarimin e kontrates se punes, per shkelje disiplinore ose me vete kerkesen e te interesuarit. Largimi nga shoqeria behet mbasi jane shlyer te gjitha detyrimet materiale dhe monetare.

Neni 19

Dispozita Te Tjera Te Pergjithshme

Shoqeria mund te prishet para afatit te caktuar ne kete statut, ne rastet kur ndryshon afati ose kur ka nje prishje te parakoheshme per shkaqe te tjera.

Neni 20

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi emerohen nje ose disa likuidatore te cilet ndjekin operacionet e likuidimit deri ne fund dhe i paraqesin Asamblese se Ortakeve rezultatet perfundimtare te likuidimit. Ne perfundim Asambleja e Ortakeve vendos per heqjen e mandatit te tyre. Te gjitha detyrimet qe dalin nga likuidimi Asambleja e Ortakeve i merr persiper per ti shlyer me kapitalin e tij te investuar ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 21

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do te kalojne ne kompetence Gjykates.

Neni 22

Shnderrimi i shoqerise ne nje shoqeri tjeter behet me vendim te Asamblese se Ortakeve, kur plotesohen kushtet per krijimin e shoqerive te llojeve te tjera.

Neni 23


Ortaket e Shoqerise mund te bejne ndryshime e plotesime ne cdo kohe ne Statut dhe ne Aktin e Themelimit pa rene ndesh ne menyre thelbesore me nenet e pershkruara ne kete Statut.

Neni 24

Ceshtjet e tjera qe nuk trajtohen ne kete statut zgjidhen ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar si dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Ky Statut eshte perpiluar dhe firmosur sot me date 07/07/2023, ne 2 kopje me vlere te njejte me origjinalin.

Ortaku themelues


Natasya Wahyu Prativi